



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 17

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 9011 datë 20.2.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë, të financimit dhe të projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW-së për projektin “Fondi i investimeve sociale, II””.....	467
Vendim i KM nr.88, datë 13.2.2003	Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.....	478
Vendim i KM nr.90, datë 13.2.2003	Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion, në formën “ROT”, të hidrocentralit vendor, në Xhyrë Librazhd.....	484
Vendim i GjK nr.6, datë 26.2.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.66, datë 11.7.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.	485
Vendim i GjK nr.7, datë 5.3.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.3723, datë 16.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.823, datë 3.7.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.234, datë 5.3.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës	

	të Shqipërisë.....	488
Vendim i GjK nr.8, datë 25.3.2003	Me objekt shfuqizimi i vendimeve nr.8436, datë 17.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.991, datë 15.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.342, datë 22.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr. X-4, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	490

L I G J
Nr.9011, datë 20.2.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, TË FINANCIMIT DHE TË
PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT DHE KFW-SË PËR PROJEKTIN “FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE, II””**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja “ç” të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,⁸⁰

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë, e financimit dhe e projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW-së për projektin “Fondi i investimeve sociale, II””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3735, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

FINANCIMI, HUAJE DHE PROJEKTI NDËRMJET
KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN (“KFW”)
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“HUAMARRËSI”) PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE FONDI I ZHVILLIMIT SHQIPTAR (“AGJENCIA E ZBATIMIT TË
PROJEKTIT”) PËR 2.045.167,52 EURO SI KREDI
DHE 255.645,94 EURO SI KONTRIBUT FINANCIAR

Fondi i investimeve sociale, II

Në bazë të një Marrëveshjeje që do të përfundohet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Qeverisë së Shqipërisë për bashkëpunim financiar (“Marrëveshje Qeveritare”), Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW hyjnë në Marrëveshjen e huasë, financimit dhe projektit si më poshtë:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i huasë/kontributit financiar

1.1 KfW-ja do t’i japë Huamarrësit një kredi jo më shumë se 2.045.167,52 euro dhe një kontribut financiar jo më shumë se 255.645,94 euro.

Kontributi financiar nuk do të jetë i kthyesëm përderisa të kushtëzohet ndryshe në nenin 5.3.

1.2 Huamarrësi do ta kanalizojë huanë plotësisht për Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit do ta përdorë Kredinë vetëm për financimin e projekteve të vogla të infrastrukturës ekonomike dhe sociale dhe kontributin financiar për trajnim dhe trajnime të mëtejshme të inspektorëve social të FZSHS-së, dhe së pari për të paguar koston e këmbimit të huaj. Të dyja së bashku përbëjnë projektin. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW do të përcaktojnë hollësitë e projektit dhe mallrat e shërbimet që do të financohen nga huaja/ kontributi financiar me një marrëveshje të veçantë.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që do të lindin nga Huamarrësi ose Agjencia e

Zbatimit të Projektit dhe taksat e importit nuk do të financohen nga kredia.

Neni 2

Kanalizimi i huasë për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 Huamarrësi do ta drejtojë huanë dhe kontributin financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një kontribut financiar të pakthyesëm sipas një marrëveshjeje të veçantë.

2.2 Para disbursimit të parë nga huaja dhe kontributit financiar, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një kopje të Marrëveshjes së huasë specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i huasë nuk përbën ndonjë detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrime pagesash sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimet

3.1 KfW-ja do të disbursojë huanë dhe kontributin financiar në përputhje me ecurinë e projektit dhe me kërkesën e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Me një marrëveshje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të bien dakord mbi procedurat e disbursimit, në veçanti mbi evidencën që provon se shumatat e kërkuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.

3.2 KfW-ja do të ketë të drejtën të refuzojë bërjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2006.

Neni 4

Tarifa e angazhimit, interesi dhe shlyerja

4.1 Huamarrësi duhet të paguajë një tarifë angazhimi prej ¼% në vit mbi shumatat e huasë së padisbursuar. Ky detyrim angazhimi do të llogaritet për një periudhë duke filluar tre muaj mbas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe duke përfunduar në datën në të cilën janë debituar disbursimet.

4.2 Huamarrësi do të paguajë interesin mbi kredinë në shkallën prej 0.75% në vit.

Interesi do të ngarkohet që nga datat në të cilat janë debituar disbursimet, deri në datat në të cilat janë kredituar shlyerjet në llogarinë e KfW-së, specifikuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do të paguajë detyrimin e angazhimit, interesin dhe ndonjë interes mbi shumatat e papaguara në bazë gjashtëmujori sipas nenit 4.5, më 30 qershor për gjashtëmujorin e I-rë dhe 30 dhjetor për gjashtëmujorin e II-të. Pagesa e parë do të paguhet së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi do të shlyejë kredinë si më poshtë :

Këstet	Data			Shuma
1	30 dhjetor	2012	euro	34.000.00
2	30 qershor	2013	euro	34.000.00
3	30 dhjetor	2013	euro	34.000.00
4	30 qershor	2014	euro	34.000.00
5	30 dhjetor	2014	euro	34.000.00
6	30 qershor	2015	euro	34.000.00
7	30 dhjetor	2015	euro	34.000.00
8	30 qershor	2016	euro	34.000.00
9	30 dhjetor	2016	euro	34.000.00
10	30 qershor	2017	euro	34.000.00
11	30 dhjetor	2017	euro	34.000.00
12	30 qershor	2018	euro	34.000.00
13	30 dhjetor	2018	euro	34.000.00
14	30 qershor	2019	euro	34.000.00
15	30 dhjetor	2019	euro	34.000.00
16	30 qershor	2020	euro	34.000.00
17	30 dhjetor	2020	euro	34.000.00

18	30 qershor	2021	euro	34.000.00
19	30 dhjetor	2021	euro	34.000.00
20	30 qershor	2022	euro	34.000.00
21	30 dhjetor	2022	euro	34.000.00
22	30 qershor	2023	euro	34.000.00
23	30 dhjetor	2023	euro	34.000.00
24	30 qershor	2024	euro	34.000.00
25	30 dhjetor	2024	euro	34.000.00
26	30 qershor	2025	euro	34.000.00
27	30 dhjetor	2025	euro	34.000.00
28	30 qershor	2026	euro	34.000.00
29	30 dhjetor	2026	euro	34.000.00
30	30 qershor	2027	euro	34.000.00
31	30 dhjetor	2027	euro	34.000.00
32	30 qershor	2028	euro	34.000.00
33	30 dhjetor	2028	euro	34.000.00
34	30 qershor	2029	euro	34.000.00
35	30 dhjetor	2029	euro	34.000.00
36	30 qershor	2030	euro	34.000.00
37	30 dhjetor	2030	euro	34.000.00
38	30 qershor	2031	euro	34.000.00
39	30 dhjetor	2031	euro	34.000.00
40	30 qershor	2032	euro	34.000.00
41	30 dhjetor	2032	euro	34.000.00
42	30 qershor	2033	euro	34.000.00
43	30 dhjetor	2033	euro	34.000.00
44	30 qershor	2034	euro	34.000.00
45	30 dhjetor	2034	euro	34.000.00
46	30 qershor	2035	euro	34.000.00
47	30 dhjetor	2035	euro	34.000.00
48	30 qershor	2036	euro	34.000.00
49	30 dhjetor	2036	euro	34.000.00
50	30 qershor	2037	euro	34.000.00
51	30 dhjetor	2037	euro	34.000.00
52	30 qershor	2038	euro	34.000.00
53	30 dhjetor	2038	euro	34.000.00
54	30 qershor	2039	euro	34.000.00
55	30 dhjetor	2039	euro	34.000.00
56	30 qershor	2040	euro	34.000.00
57	30 dhjetor	2040	euro	34.000.00
58	30 qershor	2041	euro	34.000.00
59	30 dhjetor	2041	euro	34.000.00
60	30 qershor	2042	euro	39.167.52

TOTAL euro 2.045.167,52

4.5 Nëse ndonjë nga këstet e shlyerjes nuk është në dispozicion të KfW-së në kohën e duhur, KfW-ja mund të rrisë normën e interesit të pagesave të vonuara në përqindjen bazë, plus 3 % në vit për një periudhë duke filluar nga data e caktuar dhe përfunduar në datën në të cilën janë kredituar këto shlyerje në llogarinë e KfW-së, specifikuar në nenin 4.9. “Përqindja bazë” është përqindja e interesit të caktuar nga Deutsche Bundesbank, si përqindje bazë në përqindjen e aplikueshme në datën përkatëse. Në rastin e interesave të vonuara, KfW-ja, mund të kërkojë dëmshpërblim. Ky dëmshpërblim nuk mund të kalojë shumën e mbërritur, nëse interesi është caktuar mbi këtë interes të prapambetur, në përqindjen bazë mbizotëruese në datën e caktuar plus 3 % në vit.

4.6 Detyrimi i angazhimit, interesi dhe ndonjë detyrim i prapambetur sipas nenit 4.5 do të llogaritet bazuar në vitin me 360 ditë ose në muajin me 30 ditë.

4.7 Shuma e huasë së shlyer para kohe ose e padisbursuar duhet të kreditohet në sasi të barabarta përkundrejt të gjitha kësteve të shlyerjeve të papaguara derisa KfW-ja me dëshirën e saj të caktojë një metodë të ndryshme shlyerje në një rast të veçantë, veçanërisht në rastin e shumave për volume më të pakta.

4.8 KfW-ja ka të drejtë të kreditojë, sipas zgjedhjes së saj, pagesat e marra kundrejt pagesave për t'u paguar sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huave të konkluduara ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi do t'i dërgojë të gjitha pagesat në monedhën e Republikës Federale të Gjermanisë në llogarinë e KfW-së nr. 22560801 në Kreditanstalt für Wiederaufbau Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, SWIFT; KFWIDEFF), nuk lejohet asnjë kundërkërkesë kundrejt pagesave të tilla.

Neni 5

Ndërprerja e disbursimeve dhe shlyerjeve parakohe

5.1 Huamarrësi në çdo kohë:

a) në varësi të realizimit të detyrimeve të tij sipas nenit 8, mund të anulojë çdo shumë huaje të padisbursuar akoma;

b) mund të shlyejë huanë të gjithën ose në pjesë para maturimit.

5.2 KfW-ja nuk mund të ndërpresë disbursimet përveçse kur:

a) Huamarrësi nuk arrin të përmbushë detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat në kohën e duhur;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta, që lidhen me këtë Marrëveshje janë shkelur;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit është e paafte të provojë që huaja ose shumat e kontributit financiar janë përdorur për qëllimin e caktuar;

d) janë krijuar rrethana të jashtëzakonshme, që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, veprimin ose qëllimin e Projektit ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës së pretenduar nga Huamarrësi/ Marrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.3 Në qoftë se ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 5.2 a), b) ose c) ka ndodhur dhe nuk është shmangur brenda një periudhe të caktuar nga KfW-ja, e cila do të jetë së paku 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 a) ose 5.2 b), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të papaguara të huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit që rrjedh dhe të gjitha detyrimeve të tjera të rastësishme;

b) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave të kësaj huaje ose të kontributit financiar, pasi Agjencia e Zbatimit të Projektit është e paafte të provojë se ato janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 6

Kostot dhe shpenzimet publike

6.1 Huamarrësi do të kryejë të gjitha pagesat, që do të bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje, pa ndonjë zbritje për taksat, detyrime të tjera publike ose kosto të tjera dhe do të paguajë kostot e transferimit dhe shkëmbimit që ndodhin në lidhje me disbursimet e huasë / kontributit financiar.

6.2 Huamarrësi do të përballojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që veprojnë jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Fuqia ligjore e kësaj Marrëveshjeje dhe përfaqësimi

7.1 Në kohën e duhur, para disbursimit të parë, Huamarrësi do të pajisë KfW-në me një evidencë të pranueshme për KfW-në, që vërteton se Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas

ligjeve të tij konstitucionale dhe ligjeve të tjera për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes.

7.2 Ministri i Financave dhe persona të tillë të ngarkuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe autorizuar me specimen të firmave të mirëfillta nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Fondit të Zhvillimit Shqiptar dhe persona të tillë të ngarkuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe autorizuar me specimen të firmave të mirëfillta nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të përfundojë deri në kohën që shprehja e revokimit nga përfaqësuesit e autorizuar është marrë nga KfW-ja.

7.3 Amendamente ose shtesa të kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë shënim ose deklaratë nga Palët Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje do të jenë me shkrim. Çdo shënim ose deklaratë e tillë do të merret sapo të arrijë në adresën e mëposhtme të Palës Kontraktuese përkatëse ose në adresën tjetër të Palës Kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar Palës tjetër Kontraktuese:

Për KfW
Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 111141
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Telefax: +49- (0)69-74 31 -2944
Telex: 4 15 25 60 KfW d

Për Huamarrësin
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: +355-28494

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:
Fondi i Zhvillimit Shqiptar
Rr. e Durrësit, Instituti i Tokave
Laparakë /Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355-42-34885

7.4 Ndryshimet në këtë Marrëveshje, që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit, nuk do të kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Neni 8

Projekti:

8.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë projektin në përputhje me praktika inxhinierike dhe financiare të qëndrueshme dhe thellësisht në përputhje me konceptimin e projektit, për të cilin është rënë dakord mes Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) do të japë kontrata:

- për pajisje materiale që do të financohen nga kredia dhe që i kalojnë US \$ 50,000.00 pas një tenderi ndërkombëtar;

- për punime civile që do të financohen nga huaja dhe që i kalojnë US \$ 50,000.00 pas një tenderi konkurrues të kufizuar për firmat që veprojnë në Shqipëri;

- për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja me një vlerë kontrate deri në US \$ 50,000.00 sipas vlerësimit paraprak të çmimeve;

- për shërbime konsulence, që do të financohen nga kontributi financiar pas një tenderi konkurrues të kufizuar të paktën mes firmave që veprojnë në Gjermani.

c) do të mirëmbajë ose do të kërkojë të mirëmbahen librat dhe shënimet, duke treguar pa mëdyshje të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe duke identifikuar qartë mallrat dhe shërbimet financiar nga kjo hua/kontributi financiar;

d) do t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë, të kontrollojnë librat dhe shënimet, si dhe çdo/ose të gjitha dokumentet e tjera që lidhen me zbatimin e Projektit dhe të vizitojë Projektin dhe të gjitha instalimet lidhur me të;

e) do të pajisë KfW-në me çdo/ose të gjitha informacionet dhe relacionet mbi

projektin dhe progresin e tij në vazhdim siç mund të kërkohet nga KfW-ja.

8.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë që i referohen nenit 8.1 në një marrëveshje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të sigurojë financimin e plotë të projektit dhe, sipas kërkesës, të pajisë KfW-në me evidencën që provon se kostot e papaguara nga kjo hua/kontribut financiar janë mbuluar dhe,

b) sipas marrëveshjes së tyre të informojë menjëherë KfW-në për çdo/ose të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit.

8.4 Huamarrësi do të ndihmojë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me praktika të qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e projektit dhe në përbushjen e detyrimeve nga Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, t'i japë Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndonjë dhe të gjitha lejet e domosdoshme për zbatimin e Projektit.

8.5 Për transportin e mallrave që do të financohen nga huaja/kontributi financiar, do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat janë të njohura për Huamarrësin.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit duhet të garantojnë që personat, të cilët janë ngarkuar për përgatitjen dhe zbatimin e Projektit, dhënien e kontratës për pajisje dhe shërbime për t'u financuar dhe me kërkimin e disbursimeve të shumave të huasë/kontributit financiar, nuk do të kërkojnë, pretendojnë, japin, premtojnë ose t'u premtohen pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Në qoftë se ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera nuk do të influencohen nga kjo. Çdo boshllëk, që do të rezultojë nga kjo, do të plotësohet nga një dispozitë e përshtatshme me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk duhet të nënshkruajnë ose transferojnë garanci ose hipotekim që ndonjë mund t'i pretendojë nga kjo Marrëveshjeje.

9.4 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përfundimit do të jetë Frankfurt am Main. Në rast dyshimi në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do t'i referohet tekstit gjermanisht.

9.5 Të gjitha kontradiktat që rrjedhin nga kjo Marrëveshje dhe të gjitha polemikat mbi vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet Palëve Kontraktuese, duhet të paraqiten në seancat e arbitrazhit sipas Marrëveshjes së Arbitrazhit, që përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Kjo hua e Marrëveshjeje projekti nuk do të hyjë në fuqi deri sa të hyjë në fuqi Marrëveshja Qeveritare në të cilën ajo është bazuar.

Shkruar në gjashtë kopje origjinale, tri në gjermanisht dhe tri në anglisht.

KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU
Frankfurt am Main,
Më 5.10.2002

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I FINANCAVE
KASTRIOT ISLAMI

MARRËVESHJA E ARBITRAZHIT

REFERUAR NENIT 9.5 TË MARRËVESHJES SË HUASË, FINANCIMIT DHE PROJEKTIT
NDËRMJET KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN ("KFW")
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("HUAMARRËSI")

PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE FONDI I ZHVILLIMIT SHQIPTAR
("AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT") PËR 2.045.167,52 EURO SI KREDI DHE 255.645,
94 EURO SI KONTRIBUT FINANCIAR

Fondi i investimeve sociale, II

KfW-ja, Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit tani e tutje bien dakord për sa më

poshtë:

Neni 1

Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga Marrëveshja e financimit të huasë dhe projektit dhe të gjitha mosmarrëveshjet mbi vlefshmërinë e Marrëveshjes së financimit të huasë dhe projektit dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim nga Palët Kontraktuese, do të zgjidhen përfundimisht dhe vetëm nga Gjykata e Arbitrazhit.

Neni 2

Palët në seancat e arbitrazhit do të jenë Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nga njëra anë dhe KfW-ja nga ana tjetër. KfW-ja ka të drejtën të bëjë padi kundër Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit veçmas ose së bashku. Në mënyrë të ngjashme Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit kanë të drejtën që veçmas ose bashkë të paraqesin një padi kundër KfW-së.

Neni 3

3.1 Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre gjyqtarë të emëruar si më poshtë: një gjyqtar do të emërohet nga vetë Huamarrësi ose, në rast se Huamarrësi nuk ndërhyrë ose nuk ka ndërhyrë akoma në proces, nga Agjencia e Zbatimit të Projektit; gjykatësi i dytë nga KfW-ja dhe një gjyqtar i tretë (“kryetari”) do të emërohet me marrëveshje nga Palët ose, nëse Palët nuk arrijnë brenda 60 ditëve pas marrjes së kërkesës për arbitrazh nga mbrojtësi, me kërkesë të çdo njëres Palë, nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, ose, në rast dështimi të emërimit nga ai, nga Kryetari i Komitetit Kombëtar Zvicerian të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Në rast se ndonjë nga Palët nuk arrin të emërojë një gjykatës, ky gjykatës do të emërohet nga kryetari.

3.2 Në rastin kur ndonjë gjykatës i emëruar, sipas dispozitave të mësipërme, heq dorë ose bëhet i paafte për të vepruar si gjykatës, pasardhësi i tij do të emërohet në të njëjtën mënyrë si gjykatësi i parë. Pasardhësi do të ketë të gjitha fuqitë ligjore dhe përgjegjësitë e gjykatësit të parë në fjalë.

Neni 4

4.1 Procesi i arbitrazhit do të fillojë nga paraqitja me shkrim e një ankese nga njëra Palë për tjetrën. Një ankesë e tillë duhet të përcaktojë natyrën e pretendimit, mënyrën e zgjedhjes ose kompesimin e kërkuar, emrin e gjykatësit të caktuar nga paditësi, nëse paditësi është i autorizuar të emërojë një gjykatës sipas nenit 3.1.

4.2 Brenda 30 ditëve nga marrja e një ankese të tillë, Pala e paditur duhet të njoftojë paditësin për emrin e gjyqtarit të emëruar nga ai, nëse është i autorizuar të emërojë një gjyqtar sipas nenit 3.1.

Neni 5

Gjykata e Arbitrazhit do të mbledhet në kohën që do të caktohet nga Kryetari. Në rast se Palët nuk bien dakord për vendin e seancave të arbitrazhit, ky vend do të vendoset nga Kryetari.

Neni 6

Gjykata e Arbitrazhit vendos mbi bazën e kompetencës së saj. Ajo do të përcaktojë procedurat e saj sipas rregullave në përgjithësi të njohura të procedurës. Në çdo rast Palëve do t’u lejohet dëgjimi gojor në një seancë të rregullt. Gjykata e Arbitrazhit mund të marrë vendim, pavarësisht nëse njëra nga Palët nuk paraqitet. Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit kërkojnë miratimin e të paktën dy gjyqtarëve.

Neni 7

Gjykata e arbitrazhit do të dërgojë vendimin së bashku me arsyetimet e saj me shkrim. Një vendim i nënshkruar nga të paktën dy gjyqtarë përbën vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit. Secila Palë do të marrë një kopje të nënshkruar të vendimit. Vendimi do të jetë detyrues dhe përfundimtar. Nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, të dyja Palët marrin përsipër detyrimet për të përmbushur këtë kontratë.

Neni 8

8.1 Palët bien dakord për shpërblimin e gjyqtarëve dhe personave të tillë për drejtimin e seancave të arbitrazhit ashtu siç do të kërkohej.

8.2 Në rast se Palët nuk arrijnë të bien dakord për këtë para hapjes së seancës së Gjykatës të Arbitrazhit, ajo cakton vetë një shpërblim të arsyeshëm. Secila Palë do të përballojë nga ana e saj shpenzimet e arbitrazhit dhe kostot e arbitrazhit duhet të paguhet nga pala kundër së cilës është dhënë vendimi. Në rast se vendimi nuk është në favor të asnjërës Palë, kostot duhet të paguhet nga Palët në mënyrë proporcionale.

8.3 Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë përfundimisht mbi të gjitha çështjet që lidhen me kostot.

8.4 Palët do të jenë të detyruara veçmas ose bashkërisht për pagesën e shpërblimit të personave specifikuar në nenin 8.1.

Neni 9

Çdo ose të gjitha shënimet dhe vendimet e shpërndara nga Palët dhe Gjykata e Arbitrazhit, lidhur me seancat e arbitrimin, duhet të jenë me shkrim. Vendime ose shënime të tilla duhet të merren sapo ato të arrijnë në adresën e mëposhtme të Palës Kontraktuese korresponduese ose në një adresë tjetër, siç i është njoftuar Palës tjetër Kontraktuese.

Për KfW-në
Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 111141
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Telefax: +49- (0)69-74 31 -2944
Telex: 4 15 25 60 Kwd

Për Huamarrësin
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: +355-42-28494

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:
Fondi i Zhvillimit Shqiptar
Rr. Durrësit, Instituti i Tokave
Laparakë /Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355-42-34885

Përgatitur në gjashtë kopje origjinale, tri në gjermanisht dhe tri në anglisht.

Frankfurt am Main,
Më 5.10.2002

KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I FINANCave
KASTRIOT ISLAMI

V E N D I M
Nr.88, datë 13.2.2003

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vendimi nr.613, datë 20.12.1994 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUTI
I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

KAPITULLI I

Neni 1
Krijimi

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.8005, datë 14.10.1995 dhe ligjin nr.8961, datë 24.10.2002.

Neni 2
Emri dhe qendra

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, që më poshtë do të quhet ISKSH, është person juridik me qendër në Tiranë. ISKSH-ja është institucion shtetëror i pavarur, që vepron me drejtoritë rajonale, degët dhe agjencitë lokale në të gjithë vendin.

Neni 3
Administrimi

ISKSH-ja administron fondin e sigurimeve shëndetësore në mënyrë të pavarur. Të ardhurat dhe shpenzimet kryhen sipas ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.8005, datë 14.10.1995 dhe ligjin nr.8961, datë 24.10.2002.

Neni 4
Fondi rezervë

ISKSH-ja krijon fondin rezervë nga diferenca e të ardhurave me shpenzimet. Me miratimin e Këshillit Administrativ fondi rezervë mund të përdoret:
për disbalancimin e mundshëm të buxhetit të sigurimeve shëndetësore gjatë vitit;
për investime financiare me qëllim rritjen e të ardhurave;

për përballimin e fatkeqësive natyrore.
Në të gjitha rastet e përdorimit si më sipër, madhësia e fondit rezervë për financimin e skemës për 3 muaj do të mbetet i paprekur.

Neni 5

Burimet e financimit dhe përdorimi i tyre

Fondi i ISKSH-së krijohet:
nga kontributet e të siguruarve;
nga kontributi i Buxhetit të Shtetit;
nga donacionet;
d) nga të ardhura të tjera.
Fondi i ISKSH-së përdoret:
a) për rimbursimin e çmimit të barnave të listës së rimbursueshme;
b) për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit parësor;
c) për mbulimin e shpenzimeve të shërbimeve shëndetësore që mbulohen nga skema me ligj të veçantë;
d) për shpenzimet administrative;
e) për investimet.

Neni 6

Viti financiar i ISKSH-së është viti kalendarik 1 janar deri në 31 dhjetor.

Neni 7

ISKSH-ja mban dokumentacionin në përputhje me legjislacionin financiar në fuqi.
ISKSH-ja përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar, si dhe harton programin financiar të vitit ushtrimor. Ato përfshijnë bilancin, llogaritë e të ardhurave e të shpenzimeve dhe evidencat e tjera përkatëse. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga Këshilli Administrativ i ISKSH-së. Buxheti i ISKSH-së i paraqitet Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 8

Kontrolli

Këshilli Administrativ miraton komisionin e kontrollit për revizionimin e veprimtarisë së ISKSH-së çdo vit.

ISKSH-ja ngre strukturat e kontrollit dhe organizon kontrollin në të gjitha subjektet që kanë kontratë me ISKSH-në ose që përfitojnë nga skema.

Neni 9

Organet drejtuese

ISKSH-ja drejtohet:
a) nga Këshilli Administrativ;
b) nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 10

Përbërja e Këshillit Administrativ

1. Këshilli Administrativ është organi më i lartë ekzekutiv dhe përbëhet nga 11 anëtarë, përkatësisht;

- a) Tre anëtarë të caktuar nga Këshilli i Ministrave, që përfaqësojnë:
 - Ministrinë e Shëndetësisë;

- Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale;
- Ministrinë e Financës.
- b) Një anëtar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- c) Një anëtar nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
- d) Dy përfaqësues: një nga sindikata që ka numrin më të madh të anëtarëve dhe një nga organizata më e madhe e bujqëve.

e) Katër përfaqësues të palëve të interesuara: një nga urdhri i mjekëve, një nga një organizatë punëdhënësish, një nga prodhuesi më i madh farmaceutik në Shqipëri dhe një nga shoqata e farmacistëve.

2. Këshilli i Ministrave vendos se cila sindikatë, organizatë bujqish e punëdhënësish është më e madhja dhe cili është prodhuesi më i madh farmaceutik, që emërojnë përfaqësuesit e tyre në Këshillin Administrativ.

3. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, organizatat e mësipërme emërojnë anëtarët e Këshillit Administrativ.

Afati i shërbimit në Këshill është 4 vjet. Anëtarët mund të riemërohen.

Neni 11

Kryesia e Këshillit

Këshilli Administrativ zgjedh me votim të fshehtë kryetarin dhe 2 nënkryetarët e tij, të cilët drejtojnë veprimtarinë e Këshillit. Kryetari zgjidhet nga tre përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Mbledhja e Këshillit

Këshilli Administrativ mbledhet jo më pak se katër herë në vit.

Neni 13

Kompetencat për mbledhjen e Këshillit

Këshilli Administrativ mbledhet nga kryetari, dy nënkryetarët, me kërkesën e shumicës së anëtarëve të Këshillit dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i ISKSH-së. Drejtori i Përgjithshëm i ISKSH-së ka të drejtë të mbledhë Këshillin Administrativ, kur gjykohet se kërkojnë vendime të shpejta që nuk janë kompetencë e tij.

Neni 14

Njoftimi

Mbledhja e Këshillit Administrativ njoftohet me shkrim të paktën 10 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës. Kur mbledhja e Këshillit Administrativ thirret nga Drejtori i Përgjithshëm i ISKSH-së, mund të mos zbatohen kriteret e mësipërme.

Neni 15

Vlefshmëria e mbledhjes

Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm dy të tretat e anëtarëve. Nëse shumica nuk arrihet, mbledhja shtyhet për ditën tjetër, duke bërë edhe njëherë njoftimin e pjesëmarrësve. Për mbledhjen e përsëritur do të jetë e nevojshme gjysma e anëtarëve.

Neni 16

Dokumentacioni i mbledhjes

Për mbledhjet e Këshillit Administrativ mbahet procesverbal nga sekretarja e Këshillit Administrativ, detyrat e së cilës përcaktohen në rregulloren e brendshme të ISKSH-së.

Vendimet e Këshillit Administrativ nënshkruhen nga kryetari dhe në mungesë të tij nga një

prej dy nënkryetarëve dhe depozitohen në ISKSH.

Neni 17

Vlefshmëria e votës për vendimet

Vendimet e Këshillit Administrativ merren me shumicë absolute votash.

Anëtari i Këshillit Administrativ ka të drejtën e një vote.

Në rastet kur votat barazohen, vota e Kryetarit të Këshillit Administrativ është vendimtare.

Neni 18

Kompetencat e Këshillit Administrativ

Këshilli Administrativ ka këto kompetenca:

- a) propozon emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ISKSH-së;
- b) miraton çdo vit programin e paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm, raportin, bilancin, buxhetin vjetor dhe perspektivat tre-vjeçare të skemës së sigurimeve shëndetësore dhe ia paraqet Ministrit të Shëndetësisë;
- c) miraton investimet dhe vendos për shtimin dhe pakësimin e mjeteve themelore;
- ç) I paraqet Ministrit të Shëndetësisë ndryshime në statutin e ISKSH-së dhe në aktet ligjore e nënligjore të sigurimeve shëndetësore;
- d) vendos për lidhjen e marrëveshjeve me institucione të ndryshme ndërkombëtare të sigurimeve, miraton projekte mbi konsolidimin e skemës ose zgjerimin e saj, si dhe kontrata që kanë të bëjnë me prioritetet e zhvillimit ose me efektet financiare;
- dh) miraton kontratat tip me dhënësit e shërbimit shëndetësor, me farmacitë dhe depot e barnave;
- e) miraton rregulloret e propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm;
- ë) miraton komitetin e kontrollit për veprimtarinë e ISKSH-së;
- f) miraton aktet e ISKSH-së lidhur me administrimin dhe procedurat administrative në bazë të kompetencave që i jep ligji “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”;
- g) miraton kriteret për lidhjen e kontratave me farmacitë e rrjetit të hapur dhe me depot e barnave;
- gj) miraton rregullat për shpërblimin e mjekëve dhe punonjësve të tjerë të përfshirë në skemë;
- h) miraton përdorimin e fondit rezervë sipas statutit;
- i) miraton rregulloren e sigurimeve shëndetësore vullnetare.

Neni 19

Largimi nga Këshilli

Anëtarët e Këshillit largohen nga detyra:

- a) kur dënohen për vepra penale;
- b) kur japin dorëheqjen;
- c) kur vdesin;
- ç) kur ndryshojnë vendin e punës ose subjektin që përfaqësojnë;
- d) kur organi të cilin përfaqësojnë, argumenton se nuk zbatojnë tagrin e përfaqësuesit.

Neni 20

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit Administrativ të ISKSH-së marrin shpërblim për pjesëmarrje në mbledhjet e tij.

Masa e shpërblimit për kryetarin është 20 për qind e pagës mujore të Drejtorit të Përgjithshëm dhe për nënkryetarët dhe anëtarët 15 për qind e pagës mujore të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 21

Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Shëndetësisë me propozim të Këshillit Administrativ dhe ka këto kompetenca:

- a) drejton veprimtarinë e ISKSH-së;
- b) raporton çdo vit për veprimtarinë e ISKSH-së në Këshillin Administrativ;
- c) miraton rregulloren për funksionimin e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- ç) emëron dhe shkarkon zëvendës drejtorin e përgjithshëm dhe drejtorët e ISKSH-së;
- d) përcakton dhe miraton strukturën e ISKSH-së dhe pagat e punonjësve të ISKSH-së;
- dh) emëron dhe shkarkon punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme, drejtorët e drejtorive rajonale, degëve dhe përgjegjësit e agjencive;
- e) vendos për të gjitha çështjet e administrimit të ISKSH-së dhe raporton para Këshillit Administrativ për veprimtarinë e tij;
- ë) propozon në Këshillin Administrativ buxhetin e ISKSH-së, përdorimin e fondit rezervë, programin financiar dhe paraqet raportin vjetor, parashikimin për tre vjet dhe rregulloret e ISKSH-së lidhur me kontributet dhe problemet financiare;
- f) përfaqëson ISKSH-në në të gjitha marrëdhëniet e tij juridike dhe administrative;
- g) lidh aktmarrëveshje të përbashkëta me ISSH-në për masën e shpërblimit lidhur me mbledhjen e kontributeve nga ana e ISSH-së;
- gj) lëshon urdhra e udhëzime dhe vendos sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Trupi drejtues

Në ISKSH krijohet trupi drejtues i përbërë nga zëvendës drejtori i përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive.

Trupi drejtues është organ këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 23

Kompetencat e ISKSH-së

ISKSH-ja ka të drejtë të nxjerrë udhëzime, urdhëresa dhe akte të tjera administrative, në mbështetje të akteve ligjore dhe kompetencave që janë dhënë.

Neni 24

Marrëveshjet ndërkombëtare

ISKSH-ja ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje ose të kryejë veprimtari të përbashkëta me institucione të huaja në fushën e sigurimeve shëndetësore dhe organizata joqeveritare sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 25

Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

Nga veprimtaria e ISKSH-së caktohet një fond në lekë e në valutë që përdoret për pagesat e kuotizacionit të anëtarësisë në organizma ndërkombëtare, shpenzime për udhëtime dhe dieta jashtë shtetit për specialistët e ISKSH-së për aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, pritje e përcjellje delegacionesh e specialistësh të huaj, madhësia e të cilëve caktohet nga Këshilli Administrativ.

Neni 26

Trajnime

Fondet për zhvillimin e trajnimeve që organizohen nga ISKSH-ja planifikohen në një zë të veçantë të buxhetit të Institutit.

Neni 27
Logo vula

Këshilli Administrativ miraton logon e ISKSH-së. Vula e tij përcaktohet nga dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 28
Të tjera

Për problemet që nuk janë të përcaktuara në këtë statut rregullimi do të bëhet me vendim të Këshillit Administrativ brenda dispozitave ligjore në fuqi dhe kompetencave që i janë dhënë ISKSH-së.

V E N D I M
Nr.90, datë 13.2.2003

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION, NË FORMËN “ROT”,
TË HIDROCENTRALIT VENDOR, NË XHYRË LIBRAZHD**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1997 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë” dhe të nenit 2 të ligjit nr.8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”, me propozimin e Ministrisë të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrisë të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të hidrocentralit vendor, në Xhyrë, në rrethin e Librazhdit, me shoqërinë “AMAL” sh.p.k. Librazhd, sipas propozimit të pakërkuar.
2. Forma e koncesionit të jetë “ROT” (rehabilitim, operim, transferim).
3. Organi shtetëror i autorizuar (OSHA) për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës koncesionare të jenë Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë.
4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 6, datë 26.2.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Zija VuciAnëtar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj SauliAnëtar i ““
Alfred KaramuçoAnëtar i ““
Kujtim PutoAnëtar i ““

Petrit Plloçi Anëtar i “““
Sokol Sadushi Anëtar i “““
Kristofor Peçi Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datat 12.12.2002, 13.12.2002 dhe 20.12.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.210/4 Akti që i përket:

KËRKUES:

1. FOTO ÇELO
2. ELENİ DHIMARKO
3. OLIMBI JARAZI
4. EVANTHI PUÇI, të gjithë, të përfaqësuar nga avokat Abaz Brati, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. LLAZO ÇELO
2. SOFOKLI ÇELO, të përfaqësuar nga avokat Viktor Ikonimi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.66, datë 11.7.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 41/1 dhe 42/1 të Kushtetutës dhe neni 27 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit:

- Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë është bërë pa u thirrur dhe pa u dëgjuar palët, duke injoruar ndryshimet që i janë bërë nenit 498 të Kodit të Procedurës Civile.
- Kolegji Civil ka deformuar konceptin e provës dhe të faktit të ri. Kushtet që duhet të plotësojë kërkuesi për rishikim vendimi jepen në nenin 497 të Kodit të Procedurës Civile dhe gjykata nuk ka të drejtë të bëjë interpretime tej përmbajtjes së dispozitës.
- Në rast se kërkesa kishte mangësi, ajo sipas nenit 497 të Kodit të Procedurës Civile duhej të kthehej për plotësim dhe jo të vendosej mospranimi.
- Gjatë gjykimit të çështjes, këto prova nuk dihehin dhe nuk kishte mundësi të dihehin, sepse ato u gjetën në Arkivin e Shtetit në datën 8.5.2002.
- Procesi i parregullt rezulton edhe nga fakti se në përbërjen e kolegjit kanë marrë pjesë disa gjyqtarë, që janë pozicionuar kundër kërkesës në një vendim tjetër.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesit kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Sarandë për rishikim të vendimit civil nr.708, datë 27.7.1995 të kësaj gjykate, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr.940, datë 16.2.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimin nr.142, datë 8.10.1996 të Gjykatës së Kasacionit.

Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë ka pranuar kërkesën për rishikim dhe me vendimin nr.93, datë 23.2.1998 ka prishur vendimin e atakuar. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.502, datë 30.9.1999, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt, rrëzimin e kërkesës për rishikim. Ky vendim i gjykatës së apelit, është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.403, datë 9.4.2001. Kërkuesit kanë ushtruar rekurs në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por Kolegji Seleksionues i kësaj gjykate, me vendimin nr.3, datë 18.7.2001, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Duke u bazuar në ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, sipas të cilit kërkesa për rishikim i vendimit që ka marrë formë të prerë paraqitet përpara Gjykatës së Lartë, kërkuesit në datën 4.6.2002 kanë paraqitur në këtë gjykatë një kërkesë tjetër për rishikim të vendimit që ka marrë formë të prerë, pasi është lënë në fuqi nga të gjitha shkallët e gjykimit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, që ka shqyrtuar këtë kërkesë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.66, datë 11.7.2002, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, duke arsyetuar ndër të tjera se provat e paraqitura nga kërkuesit me shkresë nuk janë të reja, pra nuk përbëjnë shkak për rishikim të vendimit të formës së prerë.

Gjykata Kushtetuese çmon se shkaqet e parashtruara nga kërkuesit për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nuk kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, siç parashikohet nga neni 131/f i Kushtetutës.

Kërkuesit kanë pretenduar në radhë të parë, se bazuar në ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile, kërkesa për rishikim nga Gjykata e Lartë duhej të shqyrtohej në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve dhe jo në dhomën e këshillimit.

Shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, në rastin konkret, ka cenuar zhvillimin e një procesi të rregullt. Ndryshimet që i janë bërë titullit të III-të të Kodit të Procedurës Civile lidhur me rishikimin, kanë të bëjnë kryesisht me kompetencën për paraqitjen e një kërkesë të tillë. Kështu, kjo kërkesë paraqitet në Gjykatën e Lartë në vend të gjykatës që ka dhënë vendimin siç ishte më parë. Megjithatë, pavarësisht nga ndryshimet e bëra në nenin 498, si ndryshimi i titullit dhe heqja e shprehjes se vendimet merren në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve, nuk ka ndryshuar procedura e shqyrtimit të kërkesës për rishikim. Në paragrafin e parë të nenit 498 të ndryshuar, thuhet se: "... kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj". Nga ky përcaktim ligjor kuptohet se shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë, kur ajo është bërë jashtë kriterëve ligjore, bëhet në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Një verifikim i tillë i kërkesës, nëse i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, është atribut i dhomës së këshillimit dhe jo i seancës gjyqësore. Aq më tepër mospranimi i kërkesës vendoset pas këtij shqyrtimi paraprak dhe jo në seancë gjyqësore. Prandaj, përcaktimi në ligj, se në këto raste gjykata vendos mospranimin, dëshmon se shqyrtimi i kërkesës për rishikim për të verifikuar paraqitjen e saj sipas kriterëve ligjore, bëhet në dhomën e këshillimit. Ky është një qëndrim rigoroz i ligjvënësit, i përcaktuar edhe në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

Në të njëjtin përfundim arrihet edhe po të krahasohet përmbajtja e nenit 498 të Kodit të Procedurës Civile me nenin 453 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon shqyrtimin e kërkesës për rishikim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Kjo dispozitë, sipas ndryshimeve që i janë bërë me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, ka pothuaj të njëjtën përmbajtje me nenin 498 të Kodit të Procedurës Civile me shtesën, që në paragrafin e parë thuhet shprehimisht që, kërkesa e rishikimit shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve.

Ky plotësim i bërë me një ligj të mëvonshëm për rishikimin e vendimeve në fushën penale, tregon qartë qëllimin e ligjvënësit për shqyrtimin e këtyre çështjeve paraprakisht në dhomën e këshillimit edhe në fushën civile. Ky qëllim del nga krahasimi i përmbajtjes së këtyre neneve të Kodit të Procedurës Penale e Kodit të Procedurës Civile për mënyrën e shqyrtimit të kërkesës për rishikim, e cila është e njëjtë. Mungesa e shprehjes në Kodin e Procedurës Civile që shqyrtimi bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve (siç përcaktohet shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale), nuk do të thotë se në këtë rast do të zbatohet procedurë tjetër, përderisa edhe këtu gjykata, në mungesë të kriterëve ligjore, vendos mospranimin e kërkesës, gjë që bëhet vetëm në dhomën e këshillimit.

Një shqyrtim i tillë nuk mund të konsiderohet antikushtetues, sepse nuk mohon asnjë të drejtë të Palëve përderisa kërkesa në fakt nuk i plotëson kriteret ligjore për të kaluar çështjen në seancë.

Duke verifikuar qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e kërkesës për rishikim, Gjykata Kushtetuese thekson se kërkesa për rishikim ashtu si edhe rekursi ushtrohen vetëm kur plotësohen kriteret e caktuara ligjore, ekzistenca e të cilave verifikohet nga gjykata në dhomën e këshillimit. Në trajtimin e këtyre problemeve, Gjykata Kushtetuese nuk vendos rregulla të reja dhe as ometon dispozitat e ligjit, por vetëm sqaron kuptimin e tyre në funksion të kontrollit kushtetues për procesin e rregullt ligjor.

Përsa i përket pretendimeve të tjera të kërkuesve që kanë të bëjnë me karakterin e provave të paraqitura prej tyre, është fakt se Gjykata e Lartë, ka arsyetuar në vendim se ato nuk janë prova të reja dhe për këtë shkak ka vendosur mospranimin e kërkesës. Ky vlerësim është brenda kompetencave që i njeh ligji kësaj gjykate dhe për këtë nuk mund të bëhet rivlerësimi nga asnjë organ tjetër.

Lidhur me pretendimin se në përbërjen e kolegjit kanë marrë pjesë disa gjyqtarë që janë pozicionuar kundër tyre në një vendim tjetër, kërkesit nuk përcaktojnë se për cilin vendim dhe për cilët gjyqtarë bëhet fjalë, pra nuk argumentojnë pakushtetutshmërinë e një veprimi të tillë. Për këtë çështje janë dhënë disa vendime si për themelin dhe për dy kërkesat e rishikimit, prandaj përcaktimi dhe argumentimi konkret ishte i domosdoshëm për të provuar këtë pretendim.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi për shkelje të të drejtave kushtetuese për proces të parregullt, nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 124/f të Kushtetutës si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr.7, datë 5.3.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci Anëtar i ""

Gjergj Sauli Anëtar i ""

Alfred Karamuço Anëtar i ""

Kristofor Peçi Anëtar i ""

Xhezair Zaganjori Anëtar i ""

Petrit Plloçi Anëtar i ""

Sokol Sadushi Anëtar i ""

Kujtim Puto Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 22.1.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.11 Akti që i përket:

KËRKUES: MERKO MUHAMETAJ, përfaqësuar nga avokat Stefan Komnino, me deklaram.

SUBJEKTE TE INTERESUARA: MEHMET LAMKO, PETRIT ÇELAJ, ABAZ BAKIA, ELENİ SHURAJA, MYHLIZ MULLARAJ, QENDRIM NOGA, ISUF MIHAJ, HEKTOR HALILI E LUAN DERVISHI, përfaqësuar nga avokat Agim Hoxha, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr.3723, datë 16.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.823, datë 3.7.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.234, datë 5.3.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës të Shqipërisë.

Kërkesi ka paraqitur këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të këtyre vendimeve:

- Vendimet janë marrë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratë dhe këto kushte nuk i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka bazuar vendimin vetëm në pretendimet e të paditurve duke mos shqyrtuar asnjë nga provat e paraqitura nga kërkesi.

- Vendimet e gjykatave janë bazuar në një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm;

- Gjykata e Lartë e ka bazuar vendimin në nenin 702 të Kodit Civil duke e marrë të shkëputur nga dispozitat e tjera të këtij kapitulli.

- Subjekti i interesuar ka vepruar në mashttrim të ligjit, sepse si ndërtues nuk ka nxjerrë lejen e ndërtimit duke penguar të bëhet regjistrimi i pronës.

- Gjykatat kanë dalë jashtë objektit të padisë, sepse kanë shqyrtuar zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes së kërkuarit, pa u kërkuar prej tij.

- Gjykatat kanë shkelur parimin e barazisë para ligjit, parashikuar në nenin 18/1 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuar e përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.3723, datë 16.12.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit Merko Muhametaj kundër të paditurve Mehmet Lamko e Petrit Çelaj me objekt, konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik të kontratës së sipërmarrjes, dorëzimin e apartamentit dhe pagimin e qirasë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr.823, datë 3.7.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit me vendimin nr.234, datë 5.3.2002.

Kërkuari pretendon se gjykatat kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor dhe kanë shkelur parimin e barazisë në kuptim të neneve 42 e 18/1 të Kushtetutës, pasi nuk kanë shqyrtuar e vlerësuar provat e paraqitura prej tij. Nga materialet e çështjes nuk vërtetohet një pretendim i tillë. Barazia e mjeteve është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, por gjykata e rrethit dhe ajo e apelit nuk kanë bërë ndonjë diskriminim dhe nuk i kanë mohuar asnjë pale të drejtën për të paraqitur prova ose për të bërë prapësime. Rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka administruar e verifikuar në seancë gjyqësore provat e paraqitura nga të dyja palët, ndërsa gjykata e apelit, në rigjykimin e çështjes pas prishjes së vendimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka administruar jo vetëm provat e ndodhura në dosje, të marra më parë nga gjykatat, por ka marrë edhe prova drejtpërdrejt.

Gjykatat, në vendimet e tyre, kanë pranuar pretendimet e të paditurve se kërkuari nuk ka bërë pagesat e kësteve në afatet e në kushtet e parashikuara në kontratë. Ky vlerësim ka të bëjë me të drejtën e gjykatës për të çmuar provat pas shqyrtimit në tërësi të rrethanave të çështjes, por jo me cenimin e parimit të barazisë të parashikuar në nenin 18/1 të Kushtetutës.

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese, nuk gjen elementet e procesit jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues edhe përse i përket pretendimeve të kërkuarit për interpretim e zbatim të gabuar nga gjykatat të dispozitave të Kodit Civil për kontratat e për të drejtën e pronësisë. Gjykatat, duke u bazuar në nenin 702 të Kodit Civil për kushtet e zgjidhjes së kontratës, e kanë konsideruar të mjaftueshëm faktin e mospagimit në afat të detyrimeve për zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes të kërkuarit me ndërtuesin Mehmet Lamko, pa iu referuar edhe dispozitave vijuese të atij kreu. Interpretimi i mësipërm i dispozitave të Kodit Civil, ka të bëjë me prerogativën e gjykatave për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe nuk ka cenuar zhvillimin e procesit të rregullt ligjor.

Nuk rezulton gjithashtu që gjykatat të kenë dalë jashtë objektit të padisë, siç pretendoi kërkuari në seancë gjyqësore. Parimi i njohur procedural, sipas të cilit gjykata duhet të shprehet për gjithçka që i kërkohet dhe vetëm për atë që i kërkohet, është i lidhur me parimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor, por në rastin konkret gjykatat nuk kanë cenuar as këtë parim procedural. Në kërkesëpadi është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë së kontratës së dytë të sipërmarrjes për apartamentin për të cilin kërkuari kishte lidhur më parë kontratë sipërmarrje. Gjykata, për t'i dhënë përgjigje kërkesës, ka hetuar e ka arritur në përfundimin se zgjidhja e kontratës së kërkuarit ishte e bazuar në Kodin Civil dhe konkluzionin e saj e ka shprehur në pjesën arsyetuese të vendimit, ndërsa për objektin e kërkesës, pra, për pavlefshmërinë e kontratës së dytë të sipërmarrjes, është shprehur në pjesën urdhëruese të vendimit, kur ka vendosur rrëzimin e padisë.

Përse më sipër, shkaqet e parashtruara në kërkesë dhe në seancë gjyqësore për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve nuk përbëjnë elemente të një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të neneve 131/f e 42/1 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr.8, datë 25.3.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci Anëtar i ""

Gjergj Sauli Anëtar i ""

Alfred Karamuço Anëtar i ""

Kristofor Peçi Anëtar i ""

Xhezair Zaganjori Anëtar i ""

Petrit Plloçi Anëtar i ""

Sokol Sadushi Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 24.2.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. XHAVIT BELIU, përfaqësuar nga avokate Liliana Ruli, me prokurë.

2. MUHAMER PAZARI, përfaqësuar nga avokat Riza Hicka, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PETRIT KULLOLLI, përfaqësuar nga avokat Ilir Selenica, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr.8436, datë 17.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.991, datë 15.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.342, datë 22.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr. X-4, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.

Xhavit Beliu dhe Muhamer Pazari kanë kërkuar në Gjykatën Kushtetuese shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të sipërcituara duke parashtruar në kërkesa të veçanta pretendimet e tyre.

Kërkuesi Xhavit Beliu, i ka përqëndruar argumentet e tij për shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në këto drejtime kryesore:

- Është shkelur parimi procedural që gjykata duhet të shprehet për gjithçka që kërkohet, por pa i kaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Gjykatat kanë vënë të paditurin në pozitën procedurale të kundërpaditësit, pa ngritur kundërpadi.

- Gjykata e Kasacionit ka udhëzuar, në vendimin e saj për kthimin e çështjes për rigjykim, zbatimin e dispozitave të Kodit Civil aktual për marrëdhënie në fushën e pronësisë të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi. Kodi Civil i vitit 1982 (që duhet zbatuar në këtë rast) nuk njihte fitimin e pronësisë me bashkim e përzierje.

Kërkuesi Muhamer Pazari, ka arsyetuar në kërkesën e tij se trashëgimlënësja Maire Pazari dhe trashëgimtarët e saj nuk kanë qenë në dijeni të zhvillimit të këtij gjykimi. Nëna e tij figuron si paditëse në këtë gjykim, ndërkohë që ajo vetë nuk ka marrë pjesë dhe nuk ka autorizuar ndonjë përfaqësues për çështjen. Sipas kërkuesit është zhvilluar gjykimin pa dijeninë e tyre, duke cenuar të drejtën kushtetuese

për një proces të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuarve e të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.221, datë 4.11.2002 Gjykata Kushtetuese ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga Xhavit Beliu dhe Muhamer Pazari, për shkak se përbërja e saj nuk ka qenë e plotë dhe mendimet e gjyqtarëve janë ndarë në mënyrë të tillë që nuk arrihej të votohej për zgjidhjen përfundimisht të çështjes. Me krijimin e kushteve të favorshme për formimin e shumicës së kërkuar, Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, rifilloi shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Pretendimet e të dy kërkuarve janë përqëndruar në shkeljen e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor që kanë kryer gjykatat gjatë zhvillimit të gjykimit në të gjitha instancat.

Kërkuari Xhavit Beliu ka argumentuar përpara Gjykatës Kushtetuese se shkelja e parimit të disponibilitetit nga ana e gjykatës, si dhe zbatimi i gabuar i ligjit në kohë, janë elemente që kanë ndikuar në cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e paraqitura nga kërkuari Xhavit Beliu, të cilat lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat dhe me thelbin e çështjes, nuk përfshihen në juridiksionin e saj kushtetues. Shkeljet e ndryshme ligjore, që mund të evidentohen nga palët gjatë proceseve gjyqësore, nuk lidhen pazgjidhshmërisht me konceptin kushtetues dhe të jurisprudence europiane të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar ankesat e individëve për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk ka për qëllim të dublojë dhe të spostojë të drejtën e gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor për të zgjidhur vetë çështjet. E drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat e parashikuara në Kushtetutën tonë dhe në Konventën Europiane dhe lidhet me garancitë që u ofrohen palëve gjatë një gjykimi, në drejtim të respektimit të atyre parimeve esenciale që përbëjnë thelbin e procesit. Standarde të tilla kushtetuese si: e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, e drejta e mbrojtjes, paanësia në gjykim, gjykim publik, prezumimi i pafajësisë etj., përbëjnë elementet kryesore që Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar në jurisprudence e saj për kuptimin sa më të plotë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Lidhur me pretendimin e paraqitur nga kërkuari Muhamer Pazari, se gjykatat kanë zhvilluar një proces gjyqësor pa dijeninë e nënës së tyre dhe pa qenë ajo ose përfaqësuesi i saj i pranishëm në gjykim, Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane, në këtë rast është shkelur.

Maire Pazari, trashëgimlënësja e kërkuarit, figuron në gjykimet e zhvilluara nga të gjitha gjykatat si një ndër palët ndërgjyqëse. Nga shqyrtimi i provave të paraqitura në gjykimin kushtetues, si dhe nga dosja gjyqësore e administruar, rezulton e provuar se Maire Pazari nuk ka qenë në dijeni të zhvillimit të këtij gjykimi. Në prokurën që paditësit (familja “Beliu”, etj.), kanë lëshuar për përfaqësuesin e tyre ndodhet një shënim me shkrim dore, i shtuar mbi numrin 10 të përfaqësuarve të tjerë, se Maire Pazari përfaqësohet me një prokurë tjetër nga Kadri Pazari. Në këtë prokurë nuk rezulton të ketë nënshkruar Maire Pazari, si dhe nuk janë pasqyruar elementet e domosdoshëm, që do të mund të vërtetonin ekzistencën e një dokumenti të tillë, si numri i repertorit, i koleksionit dhe data e nënshkrimit të saj. Njëkohësisht prokura që pretendohet të jetë lëshuar nga Maire Pazari nuk ndodhet e administruar në asnjë nga proceset gjyqësore që janë zhvilluar ndaj saj.

Ka qenë detyrë e gjykatës, që në fillim të procesit gjyqësor kur është formuar ndërgjyqësia që këtë parregullsi evidente të prokurës dhe të mospasjes së dijenisë nga pala për gjykim, ta evitonte duke kërkuar administrimin në dosje të prokurës së përfaqësimit në emër të Maire Pazarit. Zhvillimi i gjykimit në këtë mënyrë, si dhe fakti se efektet e këtij vendimi gjyqësor që ka marrë formë të prerë shtrihen edhe mbi Maire Pazarin, pavarësisht nga mosdijenja e saj për gjykimin, i ka vënë në pamundësi ligjore trashëgimtarët e saj për të kërkuar të drejtat e tyre në rrugën e zakonshme gjyqësore.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, çmon se procesi në të gjitha instancat gjyqësore është zhvilluar pa dijeninë e Maire Pazarit dhe të trashëgimtarëve të saj, gjë që përbën shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 74 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimeve nr.8436, datë 17.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.991, datë 15.01.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.342, datë 22.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.X-4, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.

- Çështja dërgohet për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër qëndrimit të shumicës për këto arsye:

1. Nga materialet e çështjes, me prokurën që paditësit kanë lëshuar para noterit, rezulton se Maire Pazari, përfaqësohet nga Kadri Pazari. Sipas saj atë e ka nënshkruar dhe vetë Maire Pazari. Duke qenë kështu, me të drejtë gjykatat (ajo e faktit, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë) janë mbështetur tek ky dokument zyrtar, i cili duhet të vlerësohet si i pakontestueshëm, përderisa ai nuk është goditur për falsitet apo si i pavërtetë.

Këtë fakt duhej ta vlerësonte në këtë mënyrë dhe shumica, që në raste të tjera nuk ka kontestuar vërtetësinë e akteve të tilla për aq kohë s’kanë qenë goditur për falsitet.

2. Palët në proces kanë shumë vite që kanë konflikte, prandaj kanë marrë pjesë dhjetra e dhjetra herë në gjykime të natyrave të ndryshme. Në këto gjykime që kanë qenë pjesëmarrës, nuk janë ngritur pretendimet që kërkuesit kanë parashtruar në kërkesën drejtuar kësaj Gjykate. Për më tepër, deri në vitin 2000, ata s’kanë bërë asnjë kërkesë kundër vendimeve përfundimtare.

3. Maire Pazari së bashku me 11 persona të tjerë kanë qenë pjesëmarrës në proces me cilësinë e paditësit. Ata janë të afërt midis tyre, gjë që dëshmon për të kundërtën e asaj që pretendon kërkuesi. Lidhur me këtë, paditësit e tjerë nuk kanë pretenduar asnjëherë në asnjë shkallë gjykimi se Maire Pazari s’ka pasur dijeni për gjykimin.

4. Nga studimi i akteve të krijohet përshtypja se pranimi ose jo i kërkesës lidhur me këtë problem, në fund të fundit është një çështje fakti, që i përket bindjes së brendshme të Gjykatës, vlerësimi i të cilit nuk është atribut i kontrollit kushtetues.

Në këto rrethana, çmoj se kërkesa duhej rrëzuar.

KRYETAR
Fehmi Abdiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 17.3.2003
Doli nga shtypi më 17.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë